

## RAPORT MJEDISOR PËR FSHATIN SUÇ

Fshati Suç në Njësinë Administrative me të njëjtin emër në Bashkinë e Klosit po përballlet me mungesën e infrastrukturës përse i përket shërbimit të grumbullimit dhe tërheqjes së mbeturinave të konsumit të përditshëm.

Në muajin Prill të këtij viti u kontraktova nga drejtues të projekti “Advokaci komunitare” që po zbatohet në këtë fshat. Gjatë kësaj periudhe kemi zhilluar disa takime me banorë të fshatit dhe nxënë të shkollës së mesme të Bashkuar “Haxhi Lata”, Suç. Në takime banorët nxorën në pah nevojën e përfshirjes së fshatit të tyre në sipërfaqen e grumbullimit dhe tërheqjes së mbeturinave të konsumit të përditshëm, si një nevojë e pritshme prej 30 vitesh. Fshati ndodhet në një terren që mund të aksesohet lehtë nga mjetet e pastrimit, pasi është i sheshtë dhe me banesa të grumbulluara.

Nga takimet por dhe vëzhgimet e bëra në të gjithë sipërfaqen e këtij fshati, vihet re ndotje nga mbetje të ndryshme që nga ato të letrës, plastikës, qelqit e deri tek inertet.

Zona më e ndotur mbetet ajo përgjatë bregut të lumit Mat. Në anën lindore të këtij fshati janë hedhur mbeturina të shumta të plastikës, por edhe inerte që dalin nga ndërtimet që bëjnë vetë banorët e fshatit. Këto mbeturina pas një kohe të shkurtër përfundojnë në lumin Mat duke shkaktuar një ndotje të madhe të ujit.

Pasojat e mbetjeve aty janë mbi gjallesat që rriten në këtë lum, kryesisht peshkut. Por me rritjen e temperaturave, lumi pret edhe banorët e zonës të cilët e shfrytëzojnë për tu freskuar në orët e nxehta të ditës. Pra tashmë pasojat nuk biejnë vetëm mbi gjallesat që jetojnë në ujë, por edhe tek njerëzit të cilët rrethohen nga mbeturinat në shkurret përgjatë shtratit të lumit, e lahen në një ujë të ndotur nga mbetje që hidhen përgjat bregut të tij.

Po gjatë vëzhgimit në terren, konstatoam një ndotje të madhe edhe të ambjentit përreth banesave. Shumë mbeturina, ndonëse jo të grumbulluara ishin të hedhura në livadhe apo ara të punuara. Kjo përbën një rrezik tjetër për hëndetin e vetë banorëve pasi ndotja ju shkon në shtëpi nëpërmjet produkteve që mbjellin apo një tjetër pasojë është gëlltitja nga kafshët shtëpijake që ato mbajnë.

Një tjetër problematikë që vumë re gjatë kësaj periudhe por edhe nga dëshmitë e vetë banorëve, ishte djegia e mbeturinave. Një pjesë e madhe e tyre i digjnin mbetjet që prodhonin pranë banesave ose tek një pikë e përbashkët që ndodhej në anën jugore të fshatit, pak metra larg bregut të lumit Mat.

Por më shqetësuese situata paraqitet për disa nga banorët që mbetjet i digjnin pranë shtëpive. Ata na thanë se nuk lënë që tju krijohen shumë mbeturina plastike në shtëpi. Në mungesë të kontenierëve apo dhe largësisë prej pikave ku i hidhnin banorë të tjerë ata i digjnin. Shumë prej tyre këtë metodë e shihnin edhe si një ndotje më të vogël të mjedisit. Por veç anës vizuale, kjo ndotje është Akoma edhe më e rëndë pasi kimikatet që çlirohen nëpërmjet djegies, shkojnë direkt në organizmin e banorëve nëpërmjet ajrit.

Pra në fshatin Suç ndoten të tre komponentët e mjedisit, toka, uji dhe ajri.

Fshati rezulton të ketë rreth 1000 banorë, por gjysma e tyre jetojnë në pjesën fushore e cila mund të futet lehtësisht në sipërfaqen e grumbullimit dhe tërheqjes së mbeturinave. Kjo pjesë e fshatit ndahet përmes nga rruga nacionale Klos – Burrel e cila mund të shërbejë për vendosjen e kontenierëve që banorët t'i përdorin për hedhjen e mbeturinave dhe mjeti pastrues i bashkisë t'i marrë e t'i depozitojë tek pika e grumbullimit të mbetjeve për të gjithë bashkinë.

Mesatarisht një person prodhon deri në 1.8 kg mbeturina gjatë një dite. Duke e llogaritur me numrin e banorëve të fshatit Suç, del që gjatë 24 orëve në këtë fshat të prodhohen 900 kg apo 0.9 ton mbetje në ditë, në një muaj 27 ton dhe në një vit plot 324 ton mbeturina.

Duke patur këto statistika, mendojmë që numri i nevojshëm i kontenierëve në këtë fshat është 5. Do të jetë vetë Bashkia Klos e cila do të përcaktojë vendet e vendosjes së kontejnerëve me anë të një VKB-je, por ne kemi sugjerimet tona.

Duke e parë situatën nga afër, mendojmë që një kontejner të vendoset në lagjen Gjinaj në afërsi të Kishës. Një tjetër mund të vendoset në hyrje të rrugës së fshatit Kurdari në afërsi të karburantit që ndodhet në rrugën nacionale. Po ashtu, sugjerojmë që një tjetër kontejner të vendoset në hyrje të rrugës së shkollës për tu përdorur nga pjesa e banorëve që jetojnë përreth godinës së Njësisë Administrative. Një tjetër kontejner mund të vendoset në afërsi të shkollës për tu shfrytëzuar nga banorët që jetojnë aty ku dhe është zona më e populluar. Gjithashtu, sugjerojmë që një kontejner të vendoset në vendin e quajtur “Kodra e Kukës” dhe një tjetër në afërsi të “Shkëmbit të Kuq”.

Ndërsa për të shmangur ndotjen e ambjentit pranë burimit të ujit të ndërtuar në rrugën nacionale tek “Shkëmbi i kuq”, sugjerojmë që të ndërtohet një kontejner prej betoni. Ata të cilët ndalojnë pranë këtij burimi të kenë mundësi t'i hedhin mbeturinat aty dhe jo në breg të lumit.